



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE
Kërkime politike 2010/01

Trekëndëshi i brishtë

Koordinimi i policisë, gjyqtarëve dhe prokurorëve
gjatë procedurës penale në Kosovë

Prishtinë, shkurt 2010

www.kipred.net

Trekëndëshi i brishtë

Koordinimi i policisë, gjyqtarëve dhe prokurorëve
gjatë procedurës penale në Kosovë

Prishtinë, shkurt 2010

Ky studim është përkrahur nga Asociacioni i Avokatëve Amerikan, Iniciativa për Sundimin e Ligjit (ABA ROLI), me fondet e USAID.

Përgatitur nga: Krenar Gashi

Me kontributet e Betim Musliut dhe Ariana Qosaj Mustafajt

Copyright © 2010 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtrisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Luteni të kontaktoni. info@kipred.net or +381 38 227778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

Rruga “Rexhep Mala”, nr. 5A

Prishtina, Kosovo

Phone and Fax: +381 38 227778

www.kipred.net

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	5
I. Hyrje	6
II. Pasqyrë e Kornizës Ligjore	8
III. Trekëndëshi i brishtë.....	10
a) Komunikimi gjatë hetimit të rasteve penale	12
b) Policia gjyqësore.....	17
c) Seancat dhe procedura gjyqësore	19
d) Vendimet e përshpejtuara	22
IV) Kontrolli institucional i cilësisë	24
V. Rekomandimet	28

Lista e shkurtesave

BIRN	Rrjeti Ballkanit për Gazetari Hulumtuese
PGJS	Plani Gjithëpërfshirës për Statusin (Plani i Ahtisaarit)
DiD	Departamenti i Drejtësisë (UNMIK)
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë
EUR	Euro, valuta
KPGJP	Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial
NJAGJ	Njësia e Auditimit Gjyqësor
KIPRED	Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
MD	Ministria e Drejtësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
ZPD	Zyra e Prokurorit Disiplinor
OSBE	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
ZPS	Zyra e Prokurorisë Speciale
UNDP	Programi Për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. HYRJE

Sundimi i ligjit mbetet sfera më e dobët e qeverisjes në Kosovës dhe një prej sfidave kryesore për konsolidimin e plotë të shtetësisë së vendit. Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nuk arriti të vendosë një sistem efikas të drejtësisë i cili do të mund të luftonte krimin dhe të garantonte një ambient të sigurt. Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut (DiD) që administronte sistemin e drejtësisë në Kosovë deri në shpalljen e pavarësisë në shkurt 2008, ka qenë shtylla më e kritikuar e misionit nga ana e medias, shoqërisë civile por edhe të organizatave ndërkombëtare. Prokurorët dhe gjyqtarët e UNMIK-ut ishin pjesë e misionit administrativ dhe politik i cili për më tepër nuk kishte një ndarje të qartë mes legjislativit , ekzekutivit dhe gjyqësorit. Në kuptim të efikasitetit, një gjyqtar i UNMIK-ut mesatarisht në vit ka zgjidhur vetëm 1.5 raste.

Ligji dhe rendi janë identifikuar të kenë ngelur çështjet kryesore edhe pas tranzicionit politik të Kosovës dhe janë identifikuar si prioritate në Propozimin Gjithëpërfshirës për Statusin (PGJS) të përpiluar nga i Dërguari Special i OKB-së Marti Ahtisaari. Pas shpalljes së pavarësisë bazuar në PGJS, autoritetet kosovare ftuan BE-në të ndihmojnë autoritetet vendore përmes një misioni për sundimin e ligjit, EULEX, i cili vendosi stafin e vet në Kosovë në dhjetor të vitit 2008. Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për t'u dalluar nga performanca e UNMIK-ut, EULEX-i akoma po nuk ka një qëndrim të qartë mes mandatit politik dhe ushtrimit të mandatit për sundimin e ligjit siç është paraparë.¹

Pas vendosjes së EULEX-it, është themeluar Bordi i Përbashkët Këshillëdhënës mes këtij misioni dhe Qeverisë së Kosovës. Akoma mbetet për të pritur që institucionet të zhvillojnë politika kohezive dhe strategji adekuate në fushën e sundimit të ligjit. Në ndërkohë, rastet e krimeve serioze siç janë vrasjet mbesin të pazgjidhura me vite të tëra, kurse krimi i organizuar dhe krimi politik rrallë herë adresohen.

Gjykatat e Kosovës janë të stërngarkuara me raste penale dhe civile, për çfarë ata nuk posedojnë as burime njerëzore dhe as teknike për ti zgjidhur. Kosova ka një numër të vogël gjykatësish të cilët janë të stërngarkuar me raste në të

¹ Gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it nuk kanë qëndrim të qartë mbi atë se cilat ligje janë të zbatueshme në Kosovë

gjitha nivelet e gjyqësorit, Numri i tanishëm i gjyqtarëve është rreth 14 sish për 100,000 qytetarë, gjë që është numër tejet i vogël në krahasim me vendet në rajon apo edhe disa shtete të reja anëtare të BE-së. Në shtetin fqinj Mali i Zi, numri i gjyqtarëve për kokë banori (100,000) është 51, në Kroaci 41, ndërsa në Republikën Çeke dhe Hungarinë 27.

Numri i prokurorëve në Kosovë është akoma më i ultë në krahasim me atë të prokurorëve ku janë vetëm 94 prokurorë për të ngritur akuza ndaj kriminelëve të një popullate 2.1 milionëshe. Për 100,000 qytetarë në Kosovë veprojnë vetëm 3.7 prokurorë, ndërkohë që në vendin fqinj të Malit të Zi janë 13.4, në Bosnjë dhe Hercegovinë 7.3, Hungari 17.3, Danimarkë 10.3 dhe vetëm në Francë ka më pak sish, respektivisht 2.9 prokurorë.

Numri i prokurorëve në pesë Zyra të Prokurorisë së Qarkut korrespondon me numrin e gjyqtarëve në 5 Gjykata të Qarkut.² Në nivelin komunal veprojnë 126 gjykatës dhe 51 prokurorë. Aq më tepër, janë 7 Zyra të Prokurorisë Komonale të cilat duhet të mbulojnë 23 Gjykata Komunale, por që kur merret parasysh numri i vogël i prokurorëve dhe distanca gjeografike mes këtyre zyrave, një gjë e tillë faktikisht bëhet e pamundur

Procesi i vlerësimit dhe riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve është dashur të përfundojë në shkurt 2010, por as ky proces nuk ndikon në rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përkundër faktit që një gjë e tillë është identifikuar si një ndër problemet kyçe në drejtësi. Përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës i janë adresuar vazhdimisht çështjes së mungesës së stafit dhe gjykatave të stërngarkuara, por deri tani asgjë nuk është ndërmarrë në këtë drejtim. Mungesa e mbështetjes institucionale në shtimin e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve qoftë nga ana e Qeverisë së Kosovës apo bashkësisë ndërkombëtare që mbështetin këtë proces, do të mbetet një fakt brengosës i cili do të vazhdojë të pengojë zhvillimin e një sistemi efektiv të sundimit të ligjit në Kosovë.

Për të inspektuar gjendjen aktuale në institucionet e sundimit të ligjit, ky hulumtim do të përqendrohet në efikasitetin dhe bashkëpunimin e Policisë së Kosovës, prokurorisë publike dhe gjykatave. Hulumtimi do të fokusohet në kanalet e komunikimit mes këtyre tri shtyllave të sundimit të ligjit, por edhe në koordinimin dhe cilësinë e punës së tyre.

² Janë 31 prokurorë dhe 48 gjykatës

Janë identifikuar zbrazëtira në drejtësinë penale dhe performancën e gjyqësorit në zhvillimin dhe ushtrimin e hetimeve të pavarura dhe administrimin e këtyre rasteve nga ana e gjykatave. Të tri institucionet ballafaqohen me problemin e mbikëqyrjes së performancës së stafit të tyre. Policia shpesh dështon ti përgjigjet kërkesave të prokurorëve dhe gjykatësve gjatë hetimeve. Prokurorët hedhin poshtë kallëzime penale pa njoftuar policinë dhe shpesh bazuar vetëm në supozime. Gjykatësit marrin vendime pa qenë në dijeni nëse të akuzuarit janë apo nuk janë recidivistë.

Si rrjedhojë, shumë kriminelë lirohen në procedurat paragjyqësore të rasteve penale, ndërkohë që ekziston një perceptim që gjyqësori është sektori institucional më i korruptuar³. Pamundësia e këtij trekëndëshi për të siguruar sundim të ligjit portretizon Kosovën si një shtet të brishtë dhe të dobët, duke penguar kështu një zhvillim të përgjithshëm dhe ndërtimin e një shteti funksional të bazuar në sundim të ligjit.

II. PASQYRË E KORNIZËS LIGJORE

Sistemi i drejtësisë në Kosovë menaxhohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), një mekanizëm ky i pavarur përgjegjës për të siguruar pavarësi dhe paanësi të sistemit gjyqësor.⁴ KGJK është përgjegjës për transferin dhe procedimet disiplinore të gjykatësve, zhvillimin e inspektimeve gjyqësore, administrimin gjyqësor, përpilimin e rregullave për gjykata në përputhje me ligjin, punësimin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të gjykatave, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit për gjyqësorin, caktimin e numrit të gjykatësve në çdo juridiksion dhe dhënien e rekomandimeve për themelimin e gjykatave të reja⁵. KGJK është gjithashtu përgjegjës për prokurorët meqë autoritetet në Kosovë akoma nuk janë themeluar Këshillin Prokurorial të Kosovës, mekanizëm ky i paraparë edhe në Kushtetutën e Kosovës. Ministria e Drejtësisë në Kosovë (MD) menaxhon administratën e zyrave të prokurorive.

Organi më i lartë i gjyqësorit në Kosovë është Gjykata Supreme, derisa Gjykata Kushtetuese, është autoriteti final i interpretimit të kushtetutës dhe

³ Shiko Raportet e Paralajmërimeve të hershme të UNDP-së 2007, 2008 dhe 2009

⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 108

⁵ Ibid

përputhshmërisë së ligjeve me kushtetutën.⁶ Sistemi i rregullt i gjykatave është i përbërë nga 23 Gjykata Komunale, 5 Gjykata të Qarkut dhe një Gjykatë Ekonomike. Sistemi i gjykatave për kundërvajtje përbëhet nga 24 Gjykata Komunale dhe një Gjykatë e lartë për Kundërvajtje.

Prokuroria e Shtetit menaxhon një Zyrë të Prokurorisë Speciale, 5 Zyra të Prokurorisë së Qarkut dhe 7 Zyra të Prokurorisë Komunale.

Ligji Penal dhe Ligji për Procedurat Penale⁷ rregullojnë procedurat penale në Kosovë. Sipas ligjit, procedimet për vepra penale mund të iniciohen vetëm me kërkesën e prokurorit të autorizuar, e bazuar në një mocion të palës së dëmtuar apo ex officio.⁸ Prokurori udhëheq dhe mbikëqyrë punën e policisë në fazën e paraprake, ndërkohë që policia është përgjegjëse për hetimin e shkeljeve penale.⁹ Policia është e obliguar që të dorëzojë kallëzim penal apo të informojë prokurorin në ndonjë formë alternative sapo ata të marrin njohuritë mbi shkeljen e dyshuar penale.¹⁰ Legjislacioni përcakton prokurorin si udhëheqës dhe mbikëqyrës për të gjitha hetimet për vepra penale.

Ligji për Procedurën Penale definon që çdo person i cili është i privuar nga liria, sipas agjencive për fuqizimin e ligjit duhet të dalë para gjykatës brenda 72 orëve.¹¹ Kushtetuta në anën tjetër këtë kohë e definon në 48 orë.¹² Edhe pse policia, prokurorët dhe gjykatat respektojnë definicionin kushtetues, një amendamentim në Ligjin aktual për Procedurën Penale i cili do ta harmonizonte atë me kushtetutën në fuqi, do të shmangte çfarëdo konfuzioni të mëtutjeshëm.

Kodi aktual i Procedurës Penale përcakton që çdo person mund të parashtojë një kallëzim penal në polici apo prokurori.¹³ Policia dorëzon raportet penale

⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 108 dhe 112

⁷ Ligji i përkohshëm për procedure penale hyri në fuqi më 6 prill, 2004, si rregullore e UNMIK-ut e cila u amendamentua nga Kuvendi i Kosovës më 6 nëntor 2008.

⁸ Ligji i Kosovës për Procedura Penale, Neni 6

⁹ Kodi i Procedurës Penale, Neni 200

¹⁰ Ibid

¹¹ Kodi i Procedurës Penale, Neni 14

¹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 29

¹³ Kodi i Procedurës Penale, Neni 197

prokurorëve pas përfundimit të hetimeve.¹⁴ Prokurorët pastaj kanë mundësi që të kërkojnë informacione shtesë nga policia (intervista, fakte, raporte) gjatë procedimit të rastit dhe parashtrimit të aktakuzës gjykatësit të rastit, apo mund të vendosë që të dorëzojnë raportin për veprën penale.¹⁵ Në rastin e tillë, prokurorët janë të obliguar që menjëherë të informojnë policinë lidhur me vendimin e tyre.¹⁶ Prokurorët janë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe udhëzimin e aktiviteteve hetimore të policisë dhe policia është e obliguar që të përgjigjet menjëherë në kërkesat dhe nevojat e prokurorëve. Pas përfundimit të hetimeve, prokurorët ngritin paditë tek gjyqtarët e procedurës paraprake. Këta gjykatës pastaj mund të procedojnë padinë në procedurë gjyqësore apo ta anulojnë atë, pas ti kenë analizuar dëshmitë, dëgjuar deklaratën e të akuzuarit dhe të argumentet e prokurorit dhe mbrojtësve ligjor.

Ligji për Procedurë Penale, i referohet Policisë me termin ‘policia gjyqësore’. Në Kosovë nuk ekziston një institucion i tillë special i policisë. Sipas Ligjit për Polici,¹⁷ policia gjyqësore nënkupton çdo zyrtar policor i cili krahas detyrave tjera policore është i autorizuar për të kryer hetimet dhe detyrat e ngjashme nën mbikëqyrjen e prokurorit.¹⁸ Me fjalë të tjera, e tërë policia mund të kryejë detyrën e policisë gjyqësore në rast se prokurorët kërkojnë një gjë të tillë nga ata, derisa apo në rast se themelohet një polici e veçantë gjyqësore.

III. TREKËNDËSHI I BRISHTË

Komunikimi intensiv dhe bashkëpunimi cilësor mes hetuesve policor, prokurorëve dhe gjykatësve janë dy elemente të domosdoshme për të arritur një sundim efikas dhe funksional të ligjit. Trekëndëshi institucional mund të bëhet vetëm nëse ka një koordinim të fuqishëm mes këtyre tri institucioneve. Barra e punës në institucionet e sundimit të ligjit varet në mënyrë të barabartë nga të tri shtyllat e këtij trekëndëshi. Me një fjalë nëse një nga këto tri

¹⁴ Kodi i Procedurës Penale, Neni 207

¹⁵ Kodi i Procedurës Penale, Neni 208

¹⁶ Ibid


¹⁷ Ligji për Policinë Nr. 03/L-035, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 20 shkurt 2008

¹⁸ Ligji për Policinë, neni 3 dhe 10

institucione dështon atëherë i tërë trekëndëshi i sundimit të ligjit do të dështojë.

Në Kosovë, ekziston një mungesë e përgjithshme e komunikimit mes Policisë së Kosovës, zyrave të prokurorive komunale dhe të qarkut dhe gjykatave. Hetuesit e policisë, dhe në veçanti prokurorët dhe gjykatësit përballen me një barrë të papërballueshme të punës kundruall kapaciteteve të tyre. Dhe për pasojë, ata detyrohen që të procedojnë rastet e veprave penale në mënyrë të përsheptuar.

Kosovës i mungojnë mekanizmat për ruajtjen dhe përcjelljen e rasteve të kundërvajtjeve dhe veprave penale. Nuk ekziston ndonjë bazë e përbashkët e të dhënave për policinë, prokurorët dhe gjykatësit, ku ata do të mund të bazonin bashkërendimin e punëve të tyre. Ndonëse, procedimet penale nuk mund të përcillen dhe të bashkërendohen. Policia shpesh dështon t'u përgjigjet kërkesave të prokurorëve për më shumë dëshmi apo intervista gjatë procesit hetimor. Prokurorët dështojnë të mbajnë regjistrin e rasteve të tyre, njësoj ngjan edhe me gjykatësit e procedurës paraprake. Dhe përfundimisht, veprat penale hetohen dobët dhe madje shpesh edhe anulohen qoftë edhe pak para ngritjes së akuzave.



Grafikoni 1 – Trekëndëshi institucional i sundimit të ligjit

Zbrazëtirat në funksionimin e trekëndëshit institucional ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në hetimet penale, procedurat paragjyqësore, procedurat gjyqësore dhe vendimet mbi veprat penale në Kosovë. Këto tri institucione kanë një komunikim të dobët me njëra tjetrën dhe koordinimi i tyre gjatë procedimit të veprave penale është poashtu shumë i dobët. Një shembull që ilustron sesi puna e pakoordinuar ndikon në shërbimet e drejtësisë në Kosovë, mund të shihet gjatë analizës së gjykimeve të të akuzuarve që njihen si recidivist. Zyrat e Prokurorisë dhe Gjykatat nuk kanë një bazë elektronike të të dhënave ku ata do të mund të ruanin informacionet lidhur me recidivistët.¹⁹ Policia në anën tjetër ka një bazë të dhënash por shpesh dështon të përmend në kallëzimet penale nëse kryesit e veprave kanë qenë të involvuar apo edhe të gjykuar për aktivitete kriminale në të kaluarën.²⁰ Si rrjedhojë, recidivizmi shpesh nuk merret parasysh nga gjykatësit gjatë marrjes së vendimit për ndonjë aktivitet kriminal. Prandaj ky trekëndësh institucional bëhet joefikas gjatë procedurave të prokurorisë apo gjykimit për ata që janë të involvuar në aktivitetet e përsëritura kriminale.

a) Komunikimi gjatë hetimit të rasteve penale

Hetimet për veprat penale në Kosovë nuk zhvillohen si duhet për shkak të koordinimit të dobët të punës mes prokurorëve dhe policisë. Policia e Kosovës dhe Zyrat e Prokurorisë Publike nuk zhvillojnë takime të rregullta ku do të mund të këmbenin qëndrimet e tyre, të diskutonin çështjet dhe të bashkërendonin përpjekjet e tyre të përbashkëta për të luftuar krimin.²¹ Aq më tepër, hierarkia e llogaridhënies nuk është funksionale në mes të këtyre dy institucioneve. Edhe pse është paraparë që në përputhje me ligjin prokurorët të udhëheqin hetimet, në praktikë kjo nuk ndodhë.

¹⁹ Intervistat e KIPRED-it me dy gjykatës, Prishtinë, dhjetor 2009

²⁰ Ibid

²¹ Intervistat e KIPRED-it me dy hetues të policisë në Gjiilan, nëntor 2009, një hetues të policisë në prishtinë, dhjetor 2009, dy prokurorë në Prishtinë, dhjetor 2009, Driton Muharremi, gjyqtar i procedurës paraprake, Gjykata Komunale Prishtinë, 10 dhjetor 2009, dhe Hilmi Zhitia – Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, 12 janar 2010, Prishtinë

Siç u pohuar më lartë, Policia e Kosovës dhe prokuroria publike nuk posedojnë një sistem të përbashkët të të dhënave për të ruajtur dhe përcjellë veprat penale të cilat ata i hetojnë.²² Kjo nënkupton që prokurorët dhe hetuesit nuk janë të informuar vazhdimisht me punën e njëri tjetrit. Për të informuar njëri tjetrin rreth procesit hetimor, policia dhe prokurorët komunikojnë përmes memorandumeve zyrtare me shkrim të cilat zakonisht dërgohen në formë të dokumenteve të shtypura apo edhe përmes telefonave celularë.²³ Asnjë nga këto metoda nuk do të mund të jetë e regjistrueshme, dhe as policia dhe as prokurorët nuk janë të vetëdijshëm për statusin e rasteve të tyre..

Prokurorët mund të kërkojnë nga policia dëshmi të reja për një rast specifik i cili mund të jetë me muaj apo me vite të tëra i vjetër.²⁴ Sistemi i bazës së të dhënave të policisë për rastet penale, edhe pse nuk i plotëson standardet ndërkombëtare, akoma mbetet i dobishëm për procesin hetimor.²⁵ Prokurorët, në anën tjetër, nuk kanë një bazë elektronike të të dhënave dhe nuk kanë qasje në bazën e të dhënave të policisë. Për të marrë të dhëna nga baza e të dhënave të policisë, prokurorët duhet të kërkojnë nga policia që tua japë ato informacione. Kjo mungesë e koordinimit bën që hetimet e veprave penale të jenë të dobëta dhe të ngecin. Duke ia shtuar kësaj edhe barrën e punës me të cilën përballen prokurorët, atëherë bëhet plotësisht e pamundur që hetimet të zhvillohen në mënyrë të kënaqshme që do të mund të rezultojnë me aktakuza të fuqishme kundër kriminelëve.

Gjatë kryerjes së aktiviteteve ditore, hetuesit policor dhe prokurorët komunikojnë me telefona celularë.²⁶ Përdorimi i telefonave celularë është i

²² Intervistat e KIPRED-it me dy hetues të policisë në Gjilan, nëntor 2009, një hetues të policisë në Prishtinë, dhjetor 2009, dy prokurorë në Prishtinë, dhjetor 2009, Driton Muharremi, gjyqtar i procedurës paraprake, Gjykata Komunale Prishtinë, 10 dhjetor 2009, dhe Hilmi Zhitia – Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, 12 janar 2010, Prishtinë

²³ Ibid

²⁴ Intervistat e KIPRED-it me dy hetues të policisë në Gjilan në nëntor 2009, dhe një hetues policor në Prishtinë në dhjetor 2009.

²⁵ Ibid

²⁶ Intervistat e KIPRED-it me dy hetues të policisë në Gjilan, nëntor 2009, një hetues të policisë në Prishtinë në dhjetor 2009, dy prokurorë në Prishtinë në dhjetor 2009 dhe Hilmi Zhitia, Kryeprokurori I Shtetit të Kosovës më 12 janar 2010, Prishtinë.

domosdoshëm në rast të nevojës për një koordinim të shpejtë siç mund të jetë për shembull në rastet kur policia kanë nevojë për një urdhër të prokurorit për të ndaluar të dyshuarit. Një komunikim i tillë, përndryshe, nuk i plotëson standardet e një komunikimi zyrtar duke lënë kështu hapësirë për keqkuptime dhe keqinterpretime, por edhe manipulime. Policia dhe prokurorët shpesh fajësojnë njëri tjetrin për rastet e hapura që kanë mbetur nën hetime për vite të tëra. Ka raste kur policia mban në paraburgim të dyshuarit dhe pohon që ta ketë bërë me urdhër të prokurorit, pa konsultuar fare prokurorin.²⁷ Ky veprim i policisë paraqet një shkelje të procedurës penale dhe shkelje të të drejtave të njeriut.²⁸

Edhe në rastet ku ndodhë një komunikim përmes telefonit mes policisë dhe prokurorëve, ndodhin shumë shkelje dhe lëshime të procedurave, meqë prokurorët nuk mund të jenë plotësisht të informuar përmes telefonit mbi rastet. Kjo posaçërisht ndodhë në rastet e ashtuquajtura ‘vepra penale të lehta’ e që kanë të bëjnë me rastet e dhunës në familje. Ka shumë raste kur policia reagon ndaj një dhune të raportuar, dhe gjatë ushtrimit të dhunës merr një kryesin e dhunës familjare në paraburgim për të ndaluar dhunën e mëtutjeshme. Pa qenë fare në dijeni për detajet e rastit dhe pa i intervistuar të akuzuarit, prokurorët urdhërojnë policinë, përmes telefonit, që të lirojnë të akuzuarit mbi bazën e të ashtuquajturës ‘procedurë të rregullt’.²⁹ Shumë nga këto raste përfundojnë me përsëritje të veprës, posa që të akuzuarit të lirohen.³⁰ Kjo sjellje gjithashtu paraqet një shkelje penale sepse sipas Kodit të Procedurës Penale, prokurorët janë të obliguar që të analizojnë të gjitha rastet me kujdes përpara se të marrin ndonjë vendim dhe në përputhje me ligjin në fuqi në rastet e lëndimeve të lehta trupore duhet të zhvillohet përndjekja gjyqësore ex officio. Deri tani asnjë rast i tillë nuk është regjistruar në Kosovë.³¹ Ky fakt jo vetëm që tregon në zbrazëtitë në trekëndëshin

²⁷ Intervistat e KIPRED-it me Tome Gashi, avokat dhe ekspert ligjor më 14 dhjetor 2009 në Prishtinë, dhe Kujtim Kerveshi, ekspert ligjor më 6 nëntor 2009, Prishtinë

²⁸ KEDNJ


²⁹ Intervistat e KIPRED-it me dy hetuesë të policisë në Gjilan, në nëntor 2009, një hetues policor në Prishtinë në dhjetor 2009.

³⁰ Ibid

³¹ Shiko gjithashtu "Më shumë se vetëm fjalë në letër? Reagimet e autoriteteve gjyqësore ndaj rasteve të dhunës familjare në Kosovë" –Publikimi i UNDP-së së Raportit të Rrjetit të grave të Kosovës, Kaptina mbi ndjekjet penale, nëntor 2009, Prishtinë

institucional të sundimit të ligjit, por është gjithashtu edhe tregues i një sjelljeje jo të duhur nga ana e këtyre institucioneve.

Koordinimi i dobët i punës shpesh çon në rezultate të dobëta të arritura gjatë hetimeve të veprave penale në Kosovë. Dhe përfundimisht ngjan që shumë nga këto raste mbesin të hapura. Në vitin 2007, janë raportuar gjithsej 67,170 raste penale në polici, nga të cilat 10,872 mbetet akoma të hapura³². Numri i madh i rasteve të hapura vjen si pasojë e drejtpërdrejtë e koordinimit të dobët mes policisë dhe prokurorisë.



Grafikoni 2 – Rastet penale për 2007, sipas Policisë së Kosovës

Nga 56,298 raste të klasifikuara si ‘të mbyllura’, vetëm 5,185 kanë përfunduar me akuza të ngritura ndaj kryesve të veprave, ndërsa 37,589 nga to mbajnë statusin e ‘iu referuan prokurorëve.’³³ Kjo nënkupton që këto dosje janë sillur vërdallë nga prokurorët tek hetuesit e policisë pa ndonjë progres substancial në hetime.

³² Statistika të marra nga Policia e Kosovës

³³ Ibid

Edhe pse numri i rasteve të zgjidhura është mjaft i lartë, që përbën shifrën prej 84% të numrit të përgjithshëm të rasteve të policisë, metoda e zbatuar gjatë zgjidhjes së këtyre rasteve nuk është e kënaqshme. Policia e Kosovës dhe Prokuroria Publike fajësojnë njëra tjetrën për dështimet në hetimin e rasteve penale. Zyrtarët e policisë pohojnë që përqindja e rasteve të tyre të zgjidhura është e lartë dhe se janë prokurorët dhe gjykatësit e korruptuar ata të cilët po i lirojnë kriminelët duke i anuluar raportet kriminale të dorëzuara nga ana e policisë.³⁴ Prokurorët mohojnë këto akuza, duke thënë që hetuesit e policisë dorëzojnë kallëzime të dobëta penale, mbi bazën e të cilave ata nuk mund të ngritin aktakuza, dhe sërish i konsiderojnë këto raste si raste të zgjidhura.³⁵

Kodi i Procedurës Penale i obligon prokurorët që të informojnë policinë lidhur me statusin e raporteve të dorëzuara kriminale, posaçërisht për ato raporte të cilat ata vendosin që ti anulojnë.³⁶ Veç kësaj, pas anulimit të raportit kriminal, prokurorët janë të obliguar që të japin shpjegime të detajura për arsyet e anulimit të rastit të caktuar.³⁷ Në procedurat penale në Kosovë, një gjë e tillë nuk ndodhë. Duke shfrytëzuar arsyetimin e barrës së punës e cila tejkalon kapacitetet e tyre, prokurorët anulojnë kallëzimet penale pa ofruar një arsyetim për një veprim të tillë, apo edhe në rast se japin ndonjë sqarim me shkrim ata nuk ofrojnë informacione të mjaftueshme.

Për shembull, në tri vendime të ndara me shkrim, të cilat i posedon KIPRED-i, prokurorët kanë vendosur që të anulojnë raportet kriminale të dorëzuara nga policia, duke pohuar që nuk ka bazë për ngritjen e akuzave ndaj të akuzuarve pa dhënë ndonjë detal tjetër për sa i përket rastit. Madje edhe teksti i shkruar në të tri vendimet nga tre prokurorë të ndryshëm është shumë i ngjashëm, i përgjithësuar dhe i mangët. Vendime të tilla të kryera nga prokuroria përbëjnë shkelje të kodit të tyre të mirësjelljes si dhe shkelje të shumëfishta të Ligjit të Kosovës për Procedurën Penale.

³⁴ Intervistat e KIPRED-it me dy hetues të policisë në Gjilan në nëntor 2009, një hetues të policisë dhe një zyrtar policor në Prishtinë në dhjetor 2009.

³⁵ Intervistat e KIPRED-it me tre prokurorë në Prishtinë në dhjetor 2009 dhe në janar 2010.

³⁶ Ligji i Kosovës për Procedurën Penale, neni 208

³⁷ Intervistat e KIPRED-it me Tome Gashi, avokat dhe ekspert ligjor më 14 dhjetor 2009 në Prishtinë, dhe Kujtim Kerveshi, ekspert ligjor më 6 nëntor 2009, Prishtinë

Edhe përkundër faktit që Policia e Kosovës është institucioni më i lavdëruar në Kosovë, prokurorët ankohen në punën e policisë, duke thënë që ata dorëzojnë kallëzime të dobëta penale vetëm sa për të thënë që kanë zgjidhur shumicën e rasteve penale.³⁸ Raporte të tilla dorëzohen pa hetimet e duhura dhe nuk posedojnë dëshmitë substanciale.³⁹ KIPRED ka marrë tri raportet e dorëzuara nga ana e policisë prokurorëve dhe të cilat ishin anuluar për shkak të hetimeve jo të duhura të rasteve përkatëse. Prokurorët ankohen që një performancë e tillë nga ana e policisë vetëm sa vështirëson punën e tyre.⁴⁰ Në anën tjetër, ekspertët ligjor thonë që ligji e përcakton që prokurorët të jenë në krye të hetimeve dhe që është përgjegjësi e tyre që të sigurojnë cilësinë e kallëzimeve penale të dorëzuara nga policia.⁴¹ Një prej çështjeve që do të mund të zgjidhte këtë këmbim akuzash do të ishte një status qartë i definuar i policisë gjyqësore, i cili nuk është i definuar me Kodin e Procedurës Penale e as me Ligjin për Policinë.

b) Policia gjyqësore

Numri i kallëzimeve penale të dorëzuara prokurorëve gati sa përputhet me numrin e krimeve. Por numri i akuzave të ngritura nga ana e prokurorëve është shumë më i vogël, meqë prokurorët hedhin poshtë shumë kallëzime penale. Numri i aktakuzave është akoma më i vogël meqë gjyqtarët e procedurave fillestare anulojnë akuzat e prokurorëve kur ato ofrojnë dëshmi të pamjaftueshme për një rast penal.

Prokurorët e Kosovës parashihet të udhëheqin me çdo hetim mbi vepra penale që kryhet nga Policia Gjyqësore e Kosovës. Ligji i Kosovës për Procedurë Penale qartë thotë që “prokurori publik do të udhëheq dhe mbikëqyr punën e policisë së gjyqësorit në procedurën paraprake.⁴² Kjo

³⁸ Intervistat e KIPRED-it me tre prokurorë në Prishtinë në dhjetor 2009 dhe në janar 2010

³⁹ Ibid

⁴⁰ Ibid

⁴¹ Intervistat e KIPRED-it me një avokat dhe ekspert ligjor në Prishtinë më 14 dhjetor 2009, dhe Kujtim Kerveshin ekspert ligjor në Prishtinë më 6 nëntor 2009

⁴² Neni 200, paragrafi 3. Shiko gjithashtu

<http://www.unmikonline.org/regulations/2003/RE2003-26.pdf>

megjithatë nuk ndodhë. Mosemërimi policisë gjyqësore siç parashihet me Kodin Penal dhe Kodin për Procedurë Penale të Kosovës, si dhe mungesa e kanaleve të vendosura të komunikimit mes policisë dhe prokurorëve, ka bërë që prokurorët të dështojnë të jenë në krye të hetimeve për vepra penale.

Detyrat e policisë gjyqësore janë të definuara në Ligjin për Procedurë Penale.⁴³ Kjo forcë duhet të zhvillojë hetimet për vepra penale, që do të ndihmonte prokurorët dhe gjyqtarët në kryerjen e detyrave të tyre dhe do të ishin llogaridhënës ndaj prokurorëve në nivele të ndryshme.

Sipas Ligjit për Polici, policia gjyqësore nënkupton çdo zyrtar policor i cili krahas detyrave tjera policore është i autorizuar që të zhvillojë hetimet dhe detyra tjera të ngjashme nën mbikëqyrjen e prokurorit.⁴⁴ Me fjalë të tjera, policia është e obliguar që të ushtrojë detyrën policisë gjyqësore në rast se këtë ua kërkojnë prokurorët, deri në momentin kur të themelohet një forcë e veçantë e policisë gjyqësore. Në momentin kur policia ka njohuri për një rast të dyshuar për kryerjen e veprës penale përndjekur penalisht *ex officio*, ata pa vonesë duhet të informojnë prokurorin publik dhe pastaj të ofrojnë prokurorisë raportet dhe informacionet tjera relevante⁴⁵.

Tërësisht ndryshe, prokurorët thonë që ata nuk mund të funksionojnë si duhet përdërisa nuk formohet një njësi speciale e policisë, policia gjyqësore.⁴⁶ Prokurorët pohojnë që një njësi e tillë e policisë duhet të themelohet, përndryshe ata nuk kanë ndonjë mjet apo mekanizëm që do të mund ta përdornin për të detyruar Policinë e Kosovës që të jenë më efikas në performancën e tyre dhe të koordinojnë hetimet, meqë ata nuk janë llogaridhënës ndaj prokurorëve.⁴⁷

Kryeprokurori i Shtetit, Hilmi Zhitia, pohon që ekziston një konflikt i qartë në mes të Ligjit për Procedurë Penale dhe Ligjit për Policinë përse i përket ekzistimit të Policisë Gjyqësore, dhe se ky ishte një plan i qëllimshëm i

⁴³ Ligji i Kosovës për Procedurë Penale, neni 151

⁴⁴ Ligji për Policinë Nr. 03/L-035, neni 3 dhe 10

⁴⁵ Ligji i Kosovës për Procedurë Penale, neni 200, paragrafi 2

⁴⁶ Intervistat e KIPRED-it me dy prokuror në Prishtinë në dhjetor 2009, dhe Hilmi Zhitia, kryeprokurori i shtetit më 12 janar 2010, Prishtinë

⁴⁷ Ibid

Qeverisë së Kosovës për të lënë sa më pak kompetence të drejtpërdrejta Prokurorisë së Shtetit.⁴⁸

Aq më tepër, ai thekson se:

“Prokurorët mund të urdhërojnë policinë të ndërmarrin veprime të caktuara. Por ata nuk mund të kërkojnë nga ata të japin llogari, sepse betuesit e policisë janë përgjegjës t’u japin llogari hierarkisë dhe strukturave të Policisë së Kosovës, që do të thotë se betuesit e policisë kanë përgjegjësi ndaj mbikëqyrësve të tyre dhe jo ndaj prokurorëve. Sikur të kishim një Polici Gjyqësore e cila nuk do të ishte në kuadër të strukturave aktuale të Policisë së Kosovës, por që do t’i jepte llogari Zyres së Prokurorisë së Shtetit atëherë do të kishim një koordinim më të mirë gjatë betimeve për vepra penale.”⁴⁹

Avokatët dhe ekspertët ligjor kanë një interpretim ndryshe të kornizës ligjore, i cili faktikisht vë tërë Policinë e Kosovës në dispozicion të prokurorëve. Në përputhje me Ligjin për Policinë, prokurorët mund të japin urdhra policisë, dhe në rast se ato nuk respektohen, prokurorët mund të kërkojnë llogari nda ata, përmes hierarkisë së Policisë së Kosovës apo madje edhe të ngrenë padi kundër ndonjë zyrtari të caktuar i cili shkel ligjin.⁵⁰ Një interpretim aq i dallueshëm i kornizës ligjore shërben vetëm si arsyetim për prokurorët që të mos veprojnë në përputhje me mandatin e tyre dhe ashtu siç e parasheh ligji. Kjo gjë do të mund të qartësohej me një ligj të ri për prokurorinë e cila është në agjendën legjislativë të qeverisë për vitin 2010.

c) Seancat dhe procedura gjyqësore

Interpretimi që ka të bëjë me komunikimin dhe koordinimin mes policisë dhe prokurorisë ndikon edhe në procedurat paraprake. Prokurorët dhe gjyqtarët e procedurës paraprake pohojnë që policia nuk i respekton urdhrat dhe nuk i

⁴⁸ Intervistat e KIPRED-it me dy prokuror në Prishtinë në dhjetor 2009, dhe Hilmi Zhitia, kryeprokurori i shtetit më 12 janar 2010, Prishtinë

⁴⁹ Ibid

⁵⁰ Intervistat e KIPRED-it me një avokat dhe ekspert ligjor në Prishtinë më 14 dhjetor 2009, dhe Kujtim Kerveshin ekspert ligjor në Prishtinë më 6 nëntor 2009

plotëson kërkesat e tyre, si gjatë seancave ashtu edhe gjatë procedurave gjyqësore.⁵¹ KIPRED-i ka marrë pesë urdhëresa emergjente lëshuara policisë nga një gjyqtar i procedurës paraprake në Gjykatën Komunale të Prishtinës, dhe asnjëra nga ato nuk është ekzekutuar.⁵² Në të pesë rastet, urdhrat e gjykatësit ishin lëshuar për të sjellë të akuzuarin para gjykatës.

Gjykatësit në gjykata të ndryshme pohojnë të mos kenë kurrfarë informate mbi atë pse policia nuk i kryen detyrat e veta në përputhje me ligjin e zbatueshëm. Gjykata Komunale e Prishtinës ankohet që policia në Prishtinë cakton një numër të pamjaftueshëm policësh për t'ju shërbyer gjykatave.⁵³ Kësisoj, ftesat e gjykatave nuk dërgohen me kohë, të akuzuarit nuk sillen në gjykatore dhe e tërë procedura penale shtyhet për më vonë.⁵⁴ Për sistemin edhe ashtu të stërngarkuar të drejtësisë në Kosovë, një performancë e tillë e policisë nuk arsyetohet. Posaçërisht kur kihet parasysh fakti që ndryshe nga numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve, ekziston një numër i mjaftueshëm i zyrtarëve policor në Kosovë dhe Policia e Kosovës posedon resurset e nevojshme humane për të kryer detyrat e policisë gjyqësore siç e parasheh ligji.⁵⁵

Marrëdhëniet e punës së prokurorëve vis-à-vis gjyqtarëve janë shumë të ngjashme me marrëdhëniet e punës me policinë. Gjyqtarët dhe prokurorët e qarkut të njëjtë nuk takohen rregullisht për të koordinuar punën e tyre.⁵⁶ Nuk zhvillohen as konsultime standarde mes gjykatësve dhe prokurorëve të

⁵¹ Intervistat e KIPRED-it me dy gjykatës në Prishtinë në dhjetor 2009, janar 2010, dhe dy prokurorë në Prishtinë në dhjetor 2009 dhe janar 2010.

⁵² Urdhëresat e lëshuara nga gjykatësi i procedurës për rastet me numër të ID P893/04, P1147/04, P1223/04, P1286/04 dhe P1927/04, janar 2010, Prishtinë.

⁵³ Intervista e KIPRED-it me Driton Muharremi, gjykatës i procedurës, Gjykata Komunale e Prishtinës, 10 dhjetor 2009

⁵⁴ Ibid

⁵⁵ Kosova ka numrin më të vogël të gjykatësve dhe prokurorëve për kokë banori në krahasim me vendet e rajonit. Shiko Raportin e Programeve të EULEX-it, korrik 2009.

⁵⁶ Intervistat e KIPRED-it me dy gjykatër në Prishtinë në dhjetor 2009 dhe janar 2010, dhe dy prokuror në Prishtinë në dhjetor 2009 dhe janar 2010.

procedurës për sa i përket rasteve penale.⁵⁷ Si rrjedhojë, gjykatësit e procedurës paraprake janë të stërngarkuar me akuzat e dorëzuara nga ana e prokurorëve, të cilat shpesh shkruhen pa ndonjë bazë të qëndrueshme ligjore. Në tri raste, dosjet e të cilave i ka marrë KIPRED-i, prokurorët kanë ngritur akuza kundër kryesve të veprave penale pa ofruar dëshmitë për krimet e kryera.

Në një rast, prokurori propozon akuzën për një person me supozimin për vjedhjen e një veture në Novi Sad, Serbi, dhe dëshmia e vetme për këtë ishte konfiskimi i automjetit të personit nga ana e policisë. Në draft aktakuzë, prokurori madje flet për detajet teknike të aktit penal. “I akuzuari ka thyer dritaren e automjetit të parkuar në Novi Sad, ia del të ndez motorin dhe të vozisë deri në Prishtinë ku zihet nga policia” thuhet në akuzën e propozuar. Prokurori nuk i ofron gjykatësit të procedurës fillestare asnjë deklaratë nga i akuzuari, i cili, siç dëshmohet më vonë, nuk e kishte kryer krimin. Në dëgjimet e procedurës paraprake, gjykatësi ka intervistuar të akuzuarin dhe pasi ka dëgjuar anën e tij të tregimit, ku ai kishte blerë veturën e vjedhur pa qenë në dijeni se ajo veturë kishte qenë e vjedhur, atëherë akuzat u hodhën poshtë.

Prokurorët gjithashtu nuk konsultojnë gjykatësit e procedurës fillestare as para inicimit të akuzave për raste penale.⁵⁸ Si rrjedhojë, gjykatësit e procedurës paraprake anulojnë një numër të konsiderueshëm të rasteve.⁵⁹ Sikur të kishte një koordinim më të mirë mes gjykatësve të procedurës dhe prokurorëve, rastet e tilla do të hetoheshin më tutje. Por pas anulimit të rasteve nga ana e gjyqtarëve të procedurës, shpesh ndodhë që për shkak të numrit të pamjaftueshëm të prokurorëve dhe numrit të madh të kallëzimeve penale me të cilat përballen, prokurorët nuk i marrin dosjet e njëjta për të hetuar rastet më tutje.

Gjykatësit dhe hetuesit e policisë nuk janë të kënaqur me mënyrën sesi prokurorët i zhvillojnë hetime. Të stërngarkuar me numrin e lartë të rasteve, prokurorët nuk dalin në vendin e krimit, madje as në rastet e krimeve të rënda

⁵⁷ Intervistat e KIPRED-it me dy gjykatës në Prishtinë në dhjetor 2009 dhe janar 2010, dhe dy prokuror në Prishtinë në dhjetor 2009 dhe janar 2010.

⁵⁸ Intervistat e KIPRED-it me tre gjykatës në Prishtinë, dhjetor 2009 dhe janar 2010.

⁵⁹ Ibid

siç janë vrasjet.⁶⁰ Gjykatësit pohojnë gjithashtu që ata marrin dosjet për vepra penale ku prokurorët madje nuk i marrin në pyetje të akuzuarit dhe ngritin akuzat mbi bazën e intervistës së zhvilluar vetëm nga policia⁶¹ Ka raste kur ata intervistojnë të akuzuarit, dhe e bëjnë këtë pa prezencën e mbrojtësve ligjor apo avokatit.⁶² Si pasojë shumë prej kryesve të veprave që kryejnë krime lirohen për shkak të shkeljeve që bëhen gjatë procedurave. Në raste të tilla, ndodhë që kryesit e veprave të identifikohen por ata lirohen për shkak të hetimeve tejet të dobëta të zhvilluara nga prokurorët, gjegjësisht policia.

d) Vendimet e përshpejtuara

Numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve ka shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut në gjykatat e Kosovës. Në një raport të fundit të publikuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, thuhet që të drejtat që shkelen më shpesh nga ana e gjyqësorit në Kosovë janë e drejta për gjykim brenda kohës së arsyeshme, e drejta në kompensim efektiv juridik, drejta e dëgjimit para një gjykate të themeluar me ligj dhe e drejta për një vendim të arsyetueshëm të gjykatës.⁶³ Shkeljet e tilla janë kundër rregulloreve ndërkombëtare që janë në fuqi në Kosovës siç është Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Elementare të Njeriut⁶⁴.

Gjithashtu, KIPRED-i ka vërejtur që numri i rasteve penale që arrijnë në gjykim është më i ultë sesa numri i krimeve të kryera. Sistemi gjyqësor i Kosovës nuk ka të dhëna të njësuara statistikore që do të tregonin përqindjen

⁶⁰ Intervistat e KIPRED-it me një hetues të policisë në Gjilan në nëntor 2009, një hetues të policisë në Prishtinë, dhjetor 2009, dhe një gjykatës të procedurës në Prishtinë në dhjetor 2009

⁶¹ Ibid

⁶² Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Elementare, neni 13, Ligji iProcedurës Penale të Kosovës, neni 69, intervistat e KIPRED-it me një avokat dhe ekspert ligjor në Prishtinë më 14 dhjetor 2009 dhe Kujtim Kërveshi, ekspert ligjor në Prishtinë më 6 nëntor 2009.

⁶³ Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete, Misioni i OSBE-së në Kosovë, qershor 2009.

⁶⁴ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Elementare, nenet 5, 6 dhe 13

e rasteve të anuluar. Nga njëzet intervista me zyrtarë, gjykatës, prokurorë dhe hetues të policisë, ekziston përshtypja që përqindja e rasteve të pazgjidhura është shumë më e lartë ngaqë mendohet. Në anën tjetër gjykatësit dhe prokurorët ankohen madje që edhe ky numër që ka arritur deri në gjykim është tejet i lartë për numrin e pamjaftueshëm të gjykatësve dhe prokurorëve në gjykata të Kosovës sot.

Në përgjithësi duket sikur ka një tendencë për të shtyrë gjykatësit të zgjidhin sa më shumë raste që munden, gjë që bën që gjykatësit të marrin vendime të bazuara mbi supozime.⁶⁵ Kjo çon në krijimin e përgjithshëm të përshtypjes tek përfaqësuesit e gjyqësorit që gjykatat e Kosovës janë krijuar në ngut dhe pa marrë në konsideratë të gjitha dëshmitë apo pa respektuar procedurat përkatëse.⁶⁶

Shembulli i qartë që dëshmon këto raste janë rastet që kanë të bëjnë me posedimin ilegal të armëve, vepër kjo penale e cila sipas Kodit Penal të Kosovës dënohet me 1 deri 8 vite burgim apo gjobitje deri në 7,500 EUR.⁶⁷ Avokatët dhe prokurorët thonë që ka rrallë herë raste kur dikush burgoset për shkak të posedimit të armëve të zjarrit. Në vend të kësaj, gjyqtarët që dëshirojnë të arrijnë normën për raste të zgjidhura, marrin vendime dhe i dënojnë të akuzuarit me gjobitje dhe rrallë herë urdhërojnë arrestime.⁶⁸

Nga katër rastet e studiuar nga KIPRED, gjobitjet kanë qenë mes 250 EUR dhe 700 EUR. Edhe pse kjo shumë dallon dhe i lihet gjykatësit që të vendos në bazë të rrethanave se si janë konfiskuar armët nga ana e policisë, dënimet e tilla minimale janë brengosësh për faktin që ato janë lehtë të përballueshme për shumicën e kriminelëve që bartin armë. Kjo tendencë e gjobitjeve të ulta për posedimin ilegal të armëve ka çuar shpesh në përsëritje të krimeve. Aq më tepër që në mungesë të bazës së të dhënave për regjistra të veprave penale siç u përmend më herët, gjykatësit zbatojnë gjobitje të njëjta edhe për kryesit e

⁶⁵ Intervistat e KIPRED-it me përfaqësues të lartë të KGJK, më 14 janar 2009 në Prishtinë, një avokat dhe ekspert ligjor më 14 dhjetor 2009 në Prishtinë, dhe një gjykatës së qarkut në Prishtinë më 10 dhjetor 2009.

⁶⁶ Ibid

⁶⁷ Ligji Penal i Kosovës, Neni 328

⁶⁸ Intervistat e KIPRED-it me dy prokurorë në Prishtinë në dhjetor 2009 dhe janar 2010, një avokat dhe ekspert ligjor në Prishtinë më 14 dhjetor 2009.

krimeve që në fakt janë recidivist.⁶⁹ Policia shpesh dështon të përmend në kallëzimet e tyre penale nëse një kryes i caktuar i veprave është recidivist apo jo, dhe kjo vlen edhe për prokurorët të cilët gjithashtu nuk përmendin këtë fakt.⁷⁰ Prokurorët e stërngarkuar nuk ankohen për vendime të tilla.

IV. KONTROLI INSTITUCIONAL I CILËSISË

Gjendja e tanishme e sistemit të gjyqësorit në Kosovë është e dobët si pasojë e drejtpërdrejtë e numrit të pamjaftueshëm të gjykatësve dhe prokurorëve, hetimeve të dobëta, koordinimit të dobët mes policisë, prokurorëve dhe gjykatave si dhe komunikimit të dobët në mes të këtyre tri institucioneve. Por ajo që rëndon akoma më shumë sistemin për sundimin e ligjit në Kosovë është mungesa e një mekanizmi institucional që do të kontrollonte cilësinë e performancës së këtyre tri institucioneve.

KGJK është përgjegjëse për të kryer inspektime gjyqësore, punësuar dhe mbikëqyrur administratorë të gjykatave, zhvilluar dhe mbikëqyrur buxhetin e gjyqësorit, caktuar numrin e gjykatësve për çdo juridiksion dhe për të dhënë rekomandime për themelimin e gjykatave të reja.⁷¹ KGJK ka organet e veta siç janë Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD) dhe Njësia e Auditimit Gjyqësor (NJAGJ) të cilat kanë për detyrë që të sigurojnë cilësinë në punën e prokurorëve dhe gjykatësve. Të dy këto institucione veprojnë në bazë të ankesave dhe vetëm për një numër i vogël, më pak se 10%, iniciohen hetime ex officio.⁷² Kjo do të thotë që KGJK nuk ka ndonjë mekanizëm të veçantë për të përcjellë efikasitetin dhe cilësinë e punës së gjykatësve dhe prokurorëve në mënyrë të përhershme.

Dhe për rrjedhojë, KGJK asnjëherë nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të ndëshkuar ndonjë prokuror apo gjykatës për sjelljet e tyre joprofesionale apo ndonjë shkelje që mund ta kenë bërë. Kjo gjë kufizon mandatin e KGJK-së që

⁶⁹ Intervistat e KIPRED-it me dy prokurorë në Prishtinë në dhjetor 2009 dhe janar 2010, një avokat dhe ekspert ligjor në Prishtinë më 14 dhjetor 2009.

⁷⁰ Intervista e KIPRED-it me një avokat dhe ekspert ligjor më 14 dhjetor 2009.

⁷¹ Ibid

⁷² Intervista e KIPRED-it me përfaqësues të KGJK dhe ZPD

të mbikëqyrë gjykatësit dhe prokurorët në bazë të raporteve që ata dorëzojnë në KGJK⁷³. NjAGJ është mekanizmi i cili kohë pas kohe auditon punën e gjykatësve dhe prokurorëve bazuar në mostra. Ky mekanizëm nuk posedon as kapacitetet dhe as resurset për të qenë në krye të kontrollit për cilësinë për performancën e gjykatësve dhe prokurorëve.⁷⁴ Niveli i parë i mbikëqyrjes së gjykatësve duhet të jenë kryetarët e gjykatave të caktuara, dhe për prokurorët duhet të jenë kryeprokurorët. Për shkak të agjendave të stërngarkuara, gjykatësit dhe prokurorët haptas pranojnë që nuk ka mbikëqyrje të punës së tyre. ⁷⁵Kjo nënkupton që niveli i parë i mbikëqyrjes gjithashtu nuk funksionon.

Cilësia e punës së prokurorëve nuk mbikëqyret nga mbikëqyrësit e tyre të drejtpërdrejtë. Kryeprokurori i Shtetit dhe Prokurorët e Qarkut dhe ata Komunal, edhe pse mbikëqyrin drejtpërsëdrejti punën e prokurorëve, pohojnë të mos kenë asnjë përgjegjësi për cilësinë e performancës së tyre.⁷⁶ Detyrat e tyre të mbikëqyrjes ushtrohen përmes raporteve që dorëzojnë prokurorët. Regjistrat që mbahen për numrin e rasteve kur prokurorët duhet të ngrënë paditë apo të vendosin të anulojnë ato raste, mbahen në formë të dokumenteve të shtypura dhe si të tilla nuk mund të shfrytëzohen për të kontrolluar cilësinë e punës së prokurorëve.⁷⁷ Kryeprokurori i Shtetit nuk mund të tregojë numrin e kallëzimeve penale që një prokuror ka vendosur t'i anulojë, e lere më cilësinë e të dhënave tjera siç janë arsyet apo sqarimet për vendime të caktuara të prokurorëve.

Joefikasiteti i mekanizmave të kontrollit në gjyqësor gjithashtu është vënë në theks edhe nga ana e organizatave ndërkombëtare. Në tetor 2009, në Raportin e Progresit, Komisioni Evropian ka kritikuar autoritetet e Kosovës që nuk janë në gjendje të luftojnë sjelljet e këqija dhe korrupsionin në sistemin e gjyqësorit. Raporti gjithashtu thotë që "...Akuzat për korrupsion dhe praktika të këqija në gjyqësor nuk janë hetuar si duhet. Zyra e Prokurorit Disiplinor përgjegjëse

⁷³ Intervista e KIPRED-it me përfaqësues të KGJK dhe ZPD

⁷⁴ Ibid

⁷⁵ Intervistat e KIPRED-it me dy prokurorë në dhjetor 2009 në Prishtinë dhe një gjykatës në janar 2010 në Prishtinë.

⁷⁶ Intervistat e KIPRED-it me Hilmi Zhitin, Kryeprokuror i Shtetit më 12 janar 2010 në Prishtinë dhe Aleksander Lumezi, kryeprokurori komunal për Prishtinë më 13 janar 2010

⁷⁷ Intervista e KIPRED-it me Hilmi Zhitian, Kryeprokuror i Shtetit, 12 janar 2010

për këtë aktivitet nuk është plotësisht funksionale. Njësia për Auditimin e Gjyqësorit ka dhënë rekomandimet për funksionimin e gjykatave, të cilat nuk janë marrë parasysh nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.⁷⁷⁸

Sipas zyrtarëve të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, sistemi aktual mundëson kontrollin e cilësisë përmes raporteve të dorëzuara nga kryetarët e gjykatave. Secili kryetar është i obliguar që ZPD-së ti ofrojë raportet për performancën e gjykatësve. Këto raporte janë të mangëta, formale dhe të përgjithësuara dhe nuk përmbajnë ndonjë informacion specifik lidhur me performancën individuale të gjykatësve.⁷⁹ ZPD është e kufizuar në veprimet e veta, dhe ekziston një ‘solidaritet’ i përgjithshëm mes gjykatësve dhe kryetarëve të gjykatave, por edhe në vet mesin e gjykatësve, për të mos raportuar sjelljet joprofesionale apo joefikasitetin e njëri tjetrit.

Kjo dukuri e ‘solidaritetit’ është gjithashtu prezent në rastet e procedurave penale ndaj prokurorëve dhe gjykatësve.⁸⁰ Sistemi i gjyqësorit është i rregulluar në atë formë që prokurorët dhe gjykatësit të cilët kanë shkelur ligjin, do të ndiqen penalisht dhe do të gjykohen nga kolegët e tyre nga ndonjë qark tjetër. Për shembull, gjykatësit dhe prokurorët nga Prishtina do të ndiqen penalisht dhe do të gjykohen nga Gjykata Komunale apo e Qarkut të Prizrenit dhe Zyra e Prokurorisë atje, si dhe anasjelltas. Kjo është e rregulluar në këtë mënyrë për të shmangur konfliktin e interesit duke ndjekur penalisht dhe gjykuar gjykatësit dhe prokurorët nga kolegët e tyre të qarkut të njëjtë. Edhe pse ky sistem është dizajnuar për të qenë më efikas, kjo nuk ndodhë, meqë akoma ekziston një dozë ‘solidariteti’ mes gjykatësve të qarqeve të ndryshme.⁸¹ Mekanizmat e ndjekjes penale ligjore kundër gjykatësve dhe prokurorëve të dyshuar për keqveprime janë jofunksional, dhe në gjykata janë ndjekur penalisht një numër shumë i vogël i rasteve të joprofesionizmit dhe korrupsionit.

Ndryshe nga vendet tjera, në Kosovë nuk ka standarde të defnuara të cilat duhet ti përmbushin prokurorët dhe gjyqtarët gjatë performancës së tyre për të

⁷⁸ KOSOVA NËN RKSKB 1244/99 RAPORTI I PROGRESIT 2009, Komisioni Evropian i komuniteteve, Bruksel, 14 tetor 2009

⁷⁹ Intervistat e KIPRED-it dhe zyrtarë të KGJK-së dhe ZPD-së

⁸⁰ Intervistat e KIPRED-it me dy prokurorë në Prishtinë në dhjetor 2009, një avokat dhe ekspert ligjor në Prishtinë më 14 dhjetor 2009, dhe Kujtim Kerveshi, ekspert ligjor, 6 nëntor 2009

⁸¹ Ibid

qenë të vlerësuar pozitivisht nga ana e KGJK-së.⁸² Kjo nënkupton që gjyqtarët vlerësohen në bazë të raporteve kuantitative që dorëzojnë. Bazuar në raportet monitoruese nga gjykatat, gjyqtarët e ndryshëm kanë zgjidhur me sukses ndryshon për një vit.⁸³ Cilësia e vendimeve të marra nuk monitorohet në mënyrë sistematike.

Rrjedhimisht, ka shumë gjykatës dhe prokurorë të cilët dyshohet se janë të korruptuar dhe joprofesional, puna dhe performanca e të cilëve kalon pa u vërejtur.⁸⁴ Një rast ilustrues se çfarë ndodhë në rast të kësaj dukurie tregon fakti që një gjykatës komunal në Drenas/Gllogoc, i janë anuluar rreth 70% të rasteve nga Gjykata e Qarkut dhe ai nuk është përballur me asnjë pasojë për veprimet e veta.⁸⁵ Rastet e tilla sipas intervistave të zhvilluara nga KIPRED, janë të pranishme edhe në vendet tjera.

As gjykatësit dhe as prokurorët nuk kanë ndonjë normë të rasteve të caktuara që duhet trajtuar në baza mujore apo vjetore. Sistemi aktual mundëson dallime të konsiderueshme në kuptim të volumit të rasteve që zgjidhin gjyqtarët brenda vitit, si dhe mundëson një situatë të ku cilësia e punës së gjykatësve as nuk monitorohet e as nuk kontrollohet. Pasoja përfundimtare është një grumbull i madh i rasteve penale të zgjidhura dhe të pazgjidhura kudo në trekëndëshin institucional ligjor.

⁸² Intervistat e KIPRED-it me zyrtar të KGJK-së, 13 janar 2010 në Prishtinë, me dy gjykatës në dhjetor 2009 në Prishtinë, një prokuror në dhjetor 2009 në Prishtinë 2009,

⁸³ Monitorimi i gjykatave, BIRN, Prishtinë, qershor 2009

⁸⁴ Intervista e KIPRED-it me një ekspert ligjor në nëntor 2009 në Prishtinë

⁸⁵ Intervista e KIPRED-it me gjyqtarin e procedurës paraprake më 8 nëntor 2009, Prishtinë

V. REKOMANDIMET

KIPRED-i rekomandon që të ndërmerren veprimet si në vijim për të përmirësuar performancën e policisë, prokurorëve dhe gjykatësve në Kosovë:

1. Qeveria e Kosovës duhet urgjentisht të përpilojë dhe të zbatojë një strategji dhe planin të veprimit për sundimin e ligjit.
2. Strategjia duhet të përfshijë një plan të detajuar për burimet përkatëse njerëzore dhe financiare për t'i adresuar nevojat e sistemit gjyqësor të Kosovës.
3. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Policia e Kosovës (PK) duhet të krijojnë një bazë të përbashkët të të dhënave që mund të ruhet dhe të shërbejë për të koordinuar të gjitha rastet penale në Kosovë. Në këtë bazë e të dhënave duhet të kenë qasje të tri institucionet: policia, prokuroria dhe gjykatat.
4. KGJK në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të brendshme (MPB) duhet të ndërtojë një platformë komunikimi që duhet të shfrytëzohet njëkohësisht nga policia dhe prokurorët.
5. Rastet e dyshuara të korrupsionit dhe keqmenaxhimit në gjyqësor duhet të ndiqen nga Zyra e Prokurorisë Speciale (ZPS).
6. KGJK duhet të fuqizojë rolin e ZPD dhe NJAGJ. ZPD dhe NJAGJ duhet të shtojnë numrin e hetimeve ex-officio për rastet e dyshuara të keqmenaxhimit dhe korrupsionit në sistemin e gjyqësorit në Kosovë.
7. Ministria e Drejtësisë (MD) duhet rregullisht të ngritë dhe të sjellë në vëmendje urgjencën për nevojën e miratimit të Ligjit për Prokurorinë Publike të Kosovës, i cili duhet të përmbajë disa qartësi sa i përket ekzistencës së policisë gjyqësore dhe rolit të prokurorisë publike në hetimin e veprave penale.

